


BIBLIOTEKA

8 JH-1  
H 92

# ÇELO HOXHA



# Mure dhe Emra

Poezi



SHH - 1  
HPL

Çelo Hoxha

# MURE DHE EMRA

Poezi

LIBRARY OF CONGRESS  
ASHKES GILDED EDITIONS  
PRINTED IN U.S.A.  
54782

Shtëpia Botuese "Faik Konica"  
1995

## *FILLIM*

*Jashtë bie shi.*

*Po të vendosësh një gotë mbi trungun e prerë  
mbushet. Po ta përbysësh - laget.*

*Eshtë edhe dikush tjetër jashtë  
që ende unë se kam përshëndetur.*

*Ka nbaruar studimet dy vjet pas meje.  
Shërben për të trembur galat në kopësht.  
Qëndron përbys. Shkruan një letër.*

## *VRULL*

*Në dy anët e një fjale  
qëndrojnë dy burra  
-pa qenë shkronja.*

## *PARADITE*

*Zogu që troket në dritare  
është gruaja e bukur e komshiut*

*fshin urinë dhe të ftohtit  
nga xhamat  
-me sqep.*

## *SHKAK*

*I.*

*Më jep livadhin me barin e gjelbër  
natyrisht, ku të jemi shtrirë  
edhe unë edhe ti,  
të të jap pranverën e shkuar.*

*2.*

*Më jep livadhin me barin e gjelbër  
natyrisht, ku të jemi shtrirë  
edhe unë edhe ti,  
të të jap një llozhë modeste në qiel.*

## *RRALLIM*

*Mbështeta kokën në stolin e parkut  
pashë në ëndërr gratë e qytetit.  
Të gjitha ishin shtatzëna.*

*Hapa sytë:  
kalonin një për një para meje  
me fëmijët e vegjël për dore.*

## *KOMÇA*

*Dita*  
*një vajzë e vogei*  
*e goditur me një fjalë*  
*në orët e trupit.*

*keunsheli* — *Jam i lumtur që më do*  
*e mbërthej me zogj.*

*Lamtumirë e ardhme*  
*ulur në karrige.*

## *NOKTURN*

*Nata gjithandej është e përsosur.  
Rreth meje ka errësirë. Edhe rreth pemës  
edhe rreth njerëzve. Pemët nuk duken  
as njerëzit, as unë.  
Nuk duket as hëna me rrethin e verdhë.  
Dikur drita e saj e vakët  
binte mbi shpinën tonë të përbashkët  
ndërsa tani ai kthehet në shtëpi  
me të shoqen futur në shishe  
poshtë xhaketës.*

\* \* \*

*Do ta them se ç'fshihet në barkun e natës  
pema e rrëzuar që vishte brekët.*

## *DALLËNDYSHET*

*Në shtëpinë e gjyshit tim  
më saktë, në një cep të saj  
gjendet një fshikëz e zezë  
në të cilën banon armiku i gjyshit.  
Gjyshi nuk ndodhet aty, ka shkuar  
të ngrejë çerdhen e tij  
në shtëpinë e armikut të vet.*

## *OREKS*

*Vajza e Jorgjisë  
shëtit për çdo darkë  
me djalin e kasapit.*

*Ringjallen  
dhe dalin të veshur  
nga plaga ime  
e hapur.*

## *OPTIMIZËM*

1.

*Mani që kishim në oborr  
rritet në zemrën time  
me rrënjët, degët, gjethet  
dhe foletë e zogjeve.  
Zogjtë nuk piqen në prush  
por në vatër.*

2.

*Ti e di mirë  
që je vërtet e bukur,  
tashmë të duhet të më shtish  
në dorë.*

## *KUPTIM*

*Fëmijët flenë.  
Njeri pranë tjetrit.  
Të gjithë pranë askujt.  
Pranë murit fle nëna,  
muri pranë errësirës,  
gjithçka brenda gjithçkaje  
pa e ditur sekretin e qënies.  
Vet ne e veshim me dritë  
trupin dhe brengën e duhanit.*

## *BORXHI*

*Rete e ngarkuara në qiell  
shiu i tejdukshëm në re.  
Zbrazen dhe bie.*

*Zogjtë krahëhapur  
rrinë sipër tyre  
pa lëvizur.*

*Xha Mitati i vdekur  
psonis në Argjentinë,  
e bija e bukur  
do të varroset në qiell.*

*54792*

## *SQARIM*

*Nga shiu që ra  
gropat u mbushën me ujë  
gropat me ujë u bënë pellgje.*

*Dhe fryu era...*

*Gjethet ranë  
në gropën e dikurshme  
ose..  
në pellgun e sotëm.*

*Këpuca e atëhershme, me takë  
shkeli në gropën e sotme  
me ujë*

*pse kështu është pellgu?*

## *NJË COPË GAZETE*

*E mban mend ditën me shi?  
Shiu binte i qetë, i ngadaltë.  
Ti kështu the. Sa ngadalë.  
Shiu binte mbi çatinë  
e haurit mbuluar me teneqe  
voza të ndryshkura dhe ndryshk  
gjithandej.*

*E mban mend ditën me shi?*  
*Ne nuk lageshim*  
*rrinim përqafuar.*  
*Ti ishte pranë meje*  
*poshtë dorës sime*  
*një copë dru i thënë nga sopata*  
*....në kohën e duhur besoj.*  
*E mban mend ditën me shi?*  
*Pak më tutje në vatër*  
*fjalët e prera na mbulonin me zjarr nga krahët.*  
*Ti një copë dru*  
*krahu im i PRERE*  
*...e mban mend ditën me shi?*

## *MOMENT I VOLITSHËM*

*Poshtë dritares  
mbi degën e çelur të hardhisë  
s'lëviz asgjë. As dritarja.*

*Pritet të dalë  
vazhdimi i murit të bardhë  
prej të cilit shumohen mendjet.*

*Mirëmëngjes hënë  
zbrit nga kali!*

## *E DIELË REALE*

*I.*

*Afēr mēngjesit  
kēmbana u fut nē kishë  
dhe u pērkul nē gjunjë  
duke pirë ujë tē bekuar  
varur nē dëshirën  
e priftit.*

*Dang,dang!  
Fëmija qante.*

*Njerzit thanë  
është hapur kisha.*

*Prifti ledhatonte  
kokën metalike  
tē fëmijës.*

2.

*Dhjaloshi flokëverdhë  
ka përqafuar ajrin  
A më do? -e pyet.*

3.

*...dhe hiqni dorë  
njëherë e mirë  
nga mendimi  
se gjoja më njihni*

*nuk jam ai që dukem  
por ai që shfaqem.*

## *NË DRITARE*

*Shiu që ra pa ndërprerje  
e mbushi dëngëza zemrën time  
....e bëri librashitësen prej letre.*

## *PIKËLLIM*

*Hamë në pjatën prej balte  
ku pas nesh ha macja  
ose para nesh  
me lejen tonë.*

*Me gjalmin që macja torri gjatë dimrit  
është bërë një lëmsh i madh  
gruaja luan me të poshtë tavolinës.*

*Jam vërtet i lumtur:  
po të hedhësh pataten në ujë lahet  
po të jetë uji i nxeh të  
zien*

*dhe hahet në pjatën prej balte.*

*PO QE SE NUK MENDOJ  
KËSHTU*

*I kërkova nënës  
krahët e zogur  
ajo më dha  
një vajzë të bukur.*

*I kërkova vajzës  
veten e saj  
ajo më dha  
krahët e zogut.*

*Sikur të dashuroja kohën  
do ti kërkoja zogut  
krahët e nënës.*

## *NATË*

*Sa ka yje të fikur në qytet  
gjenden drita të ndezura në qiell  
bota: një mendim simetrik.*

*Gruaja është fjalë  
e thënë me tendencë  
nga një grua tjetër.*

*Edhe mund të të urrej  
duke qënë ky që jam  
o formë e squllët e asgjësë  
o hark i ushqyer i hënës.*

## *PAMJE E PJESËSHME*

*Vajza gatuan patate të skuqura  
me ujë  
ne lexojmë gazetën e lagur  
me kripë  
lajmet e fundit janë shkruar  
me vaj  
mbi fytyrën e palosur të mikeshës.*

## *SHPRESE*

*Preva një copë  
nga qielli i kaltër  
dhe e qepa  
në këmishën e grisur në betejë.*

*Copën e predhës  
që kisha në plagë  
e vura në qiellin e hapur.*

*Tani, nëna ime e mirë  
i var vandakët me drith  
në trarët e një planeti tjetër  
aty ku banojnë njerzit.*

## *DIL NË TELEFON NESËR*

*Nesër unë do të punoj përpsëri  
aty ku jam. Në gazetën lokale.  
Do të shkruaj përsëri për zjarrin.  
Për zjarrin në banesën numër dy  
brenda së cilës ndodhej një fëmi  
i cili thërriste: Ndihmë! Ndihmë!  
Emri i fëmijës është Afrim.  
Mjekët thanë: Afrimi është jashtë rrezikut.  
Dhe të gjithë do të habiten.  
Se lajmin e ke shkruar ti  
vdekur dy vjet më parë  
nga polmoniti.*

## *ASGJËSIM*

*E mbjellë në një saksi prej balte  
shetit krah meje, në trupin e hijes  
e mbajtur nga duart e nënës.*

*Nëna bëhet e padukshme  
kur nuk kam dëshirë  
ta kujtoj.*

*Njeriu e vrau mashtrimin  
me aromën e shpatës së vet  
para miliona vjetësh  
në parkun e Ri të Tiranës.*

## *DETI*

*Vishja vështrimin tim-  
trupit tënd të veshur  
para hedhjes në qelq  
para kthimit në lëng.*

*Merri luspat e dashurisë  
vishja trupit të ajrit  
para mbylljes së fundit  
para hedhjes në qelq.*

*Më vonë hidhe në qelq  
dhe kundrojë veten  
me një biletë çmimlirë  
të blerë, pak më parë.*

## *...E BUKUR*

*Malet janë të larta  
një sërë malesh rresht  
që ndahen midis tyre  
nga lumi.*

*Diku aty  
gjendet shtëpia ime  
e mbuluar me tjegulla vendi  
dhe vende-vende me kashtë...  
Aty pari kaloi një vajzë  
duke hyrë menjëherë  
në kujtesë  
la jashtë:  
malet  
shtëpitë  
lumin  
dhe veten e saj.*

## *ÇAST*

*Vogëlushe  
duhet të dish patjetër diçka  
për prejardhjen e prindërve  
nga një kokërr misri.*

*Ti je kënga e zogut të tejdukshëm  
që përveç mishit  
nuk i hahet as zëri.*

## *FYELLI*

*Ata ikën.*

*Nuk u kthyen më  
në qytetin e lindjes  
dhe morën me vete gjithçka:  
shtëpitë  
muret  
rrugët  
dashuritë...  
Në trupin e qytetit  
kanë betur  
disa vrima*

*prej andej arratiset për çdo darkë  
nata.*

## *PUTHJE*

*Kur dritarja hapet  
xhami thyhet.  
Duket qartë kandili  
i varur në mur.  
Anash janë qepet. Të varura.  
Gota metalike  
sipër fjalës TE DUA  
ra në pellgun me ujë  
  
ja, kjo na ndan.*

## *SECONDË*

*Pas shiut  
bie shi.*

*Misrat e verdhë  
janë gjysmë të zier  
në tën xheren e mbushur  
me zhurmë.*

*Gruaja e mullisit  
shkon me një burrë tjetër  
duke tradhëtuar të shoqin.*

*Shkrova një letër dashurie  
dhe kujtova Mirën:  
Gratë janë njësoj ndërsa  
flasin gjuhë të ndryshme.*

*Pastaj  
nënskrova  
fundin.*

## **ÇËSHTJE**

*U arratisa nga vetja  
duke hyrë në gjirin e dikujt  
që e doja atë çast.*

*Pashë tek rrrokullisej  
mbrapa meje, dikush  
i ngjashëm me të parin  
aty ku isha strukur*

*atë çast më donte...*

*dola nga frika  
hyra në jetë.*

## *KUJTIM*

*Në fushë punojnë katër gra.  
Me shatat që ngrenë lart  
dhe ulin përsëri poshtë  
varrosin pak nga pak hënën.*

*Ne tashmë banojmë në hënë  
dhe është toka ajo që rrotullohet  
rreth saj,  
jemi të lindur përjetësisht  
në një lëvizje të verdhë  
të zbrazur; me të cilën  
lidhim dy anët e vetes.*

*Më thuaj  
më do apo jo:  
send në gojën e zogut.*

\* \* \*

*Nga era që fryu  
loti u lëkund*

*sa herë që bie  
ma bën më të re  
me shijen e tij të kripur,  
maskën.*

## *DITA E VERËS*

*Kalorësi me kokën e prerë  
shtrëngon frerin e kalit  
dhe kthehet në shtëpi.  
Në shtëpinë mes malesh  
e pret motra  
ëndërra  
e ardhmja  
dhe pragjet e kthyer në njerëz.*

*Nëna valëvitet përjashta  
në erë  
e lidhur  
në hardhinë e prerë gabimisht.*

## *RRUDHĒ*

*Matanë gardhit  
me curma tē kalbura.  
sipër gjetheve jeshile  
tē kërcellit tē denjë për detyrën  
dielli laget në shi.*

*Miqtë e mi më tē mirë  
janë fallsifikuar  
nga nënët e tyre  
në lindje.*

## *DEKOR*

*Këngën e dëgjon  
edhe macja  
edhe gruaja.*

*Kënga e vërtet për mua  
ka dy kotele të bardha  
dhe një karrige të kuqe.*

## *RRUZULLI*

*I hip a motorrit të prishur  
që gjeta në anë të rrugës  
dhe shkova në hënë  
të blej një çokollatë*

*aty gjeta një plakë  
kërkonte mua  
qysh kur pata humbur*

## *ALKOOL*

*Kur pashë së ç'bënte*

*peshku në ujë  
zogu në ajér  
pema mbi tokë  
njeriu nën dhe*

*mbylla me kujdes  
kapakun e shishes.*

## *LËVORJA*

*Ata përqafoheshin në dhomën e zjarrit  
fort, më fort, akoma edhe më  
ndërsa Shyqyriu ecte për në Tiranë.  
Ku do të shkosh? - e pyet shoferi.  
Aty ku ndalon ky autobus. . .  
Ishallah, ndalon së bashku me shiun  
që larg njëherësh dy stacione  
-tetë orë larg.*

## *ZEMËRGJERËSI*

*Hapa sytë:  
krijova botën.*

*Shkoj drejt fundit  
pa e marrë me vete atë.*

## *ENDE TË NJOMË*

*Mbrëmjeve pinim  
raki, dhe verë.  
Në shtëpinë e Zamirës  
pa e ditur shkakun.*

*Vajzat e klasës  
mbyteshin pa fjalë  
në gotat e zbrazura  
pa e njohur sekretin  
pa e ditur psenë.*

*Pa e ditur. Pse?  
Pa e njohur. Kë?*

## *SEND*

*Forma e zmadhimit tim  
është tuneli në fijen e flokut*

*Fillon tek nëna ime  
dhe mbaron te një grua tjetër*

*Që edhe kjo është fillimi  
i një zmadhimi pa formë*

## *EKUILIBËR*

*Nëna e fëmijës kokëqethur  
ushqen djalin e saj dy vjeç.  
Me orizin e zier më parë  
në sobën elektriqe të ndezur dikur.  
Dritat janë të zbehta, të dobëta fare  
për shkak të furrave elektriqe  
që janë të ndezura në të tjera shtëpi.  
Më jep, të lutem, vështrimin e kësaj gruaje  
ta mbyt në një gotë të mbushur me ujë  
dhe po deshe, pusho se mjaullituri macen.*

## *ÇLIRIM*

*Vajzat flenë të zhveshura  
në hije të pemës,  
frym erë dhe bën fresh  
njëra është krejt lakuriq  
i hoqi edhe syzat.*

*MIMOZA P.*

*Gruaja*

*tri pyetje që piqen  
mbi rërë.*

## *ISHE...*

*Ishe e fejuar.  
Burri yt pat qënë zemërgjerë  
për deri sa në të  
ishe ulur ti këmbëkryq  
së bashku me xhupin rozë...  
... i cili me dhuroi pa dashje  
lotët e burrit tim.*

## *QËNIE*

*Eja e dashur, dhe kur të vish  
puthma ballin e lodhur nga pritja  
pastaj qëndro e më bëj shoqëri.  
Sa shumë të ngjan filxhani i çajit:  
është plot dhe jo transparent  
je transparente dhe bosh.*

## *ZOGU*

*Dita rrotullohet rreth tij  
pa mundur të pështyje në trung.*

*Ndjenja lind  
fëmija përftohet.*

*Fillimisht vdiq një grua  
pastaj nëna e tij.*

## *DIMËR*

*Ngrihet natën nga shtrati  
dhe ende pa u zbardhur mirë  
fluturon një copë herë në qiel.  
E sodis me sy të mbyllur  
deri sa dita vjen ngadalë  
dhe ajo shuhet mbi një degë  
...mizorish.*

## *TRUPAT*

*Jeta rrjedh nga gishtat e tu  
dhe hyn në zemrën time nga floket  
që thinjen në trupin e kohës.*

*Je kaq e prekshme  
pa qënë e lëngët  
të jesh e padukshme  
e të mos biesh në sy!*

## *UJËVARË*

*Djelmoshat pa kapele  
luajnë në një fushë të kaltër.*

*Vjen dikush  
dhe gjuan me forcë topin e qethur  
që bie në pasqyrën jeshile*

*ku rruhet  
uniforma dhe autoriteti.*

## *E DIEL*

*I dëgjon sazet që bien?  
Vijnë nëpër trupin e njomë të ditës  
trup me lagështirë të zbrazet.*

*Po gjethet e thara që bien  
i shikon? Mbi supin e tingujve  
rrjedhin në damarët e ajrit.*

*Ato janë mikrobe të bukura  
që martohen seriozisht si njerëz  
pa e ditur shakanë e fshehur në vello.*

## *E ŸMA*

*Një grua qan.  
Burri mban për supesh  
gruan që qan.*

*Se kemi gjetur ende  
ilaçin që parandalon  
rënien e flokëve të pemës.*

## *UDHË*

*A ka rënë dëborë jashtë, mor bir ?  
Po, mama, ka rënë. Shumë ka rënë.  
A ka mbuluar gjithçka, mor bir ?  
Po, mama, e ka mbuluar.  
Po kasollen e qenit, a e ka mbuluar ?  
E ka mbuluar, mama, e ka mbuluar.  
Po qeni, a është mbi dëborë, mor bir ?  
Po bir, është.*

## *MIMOZA*

*Eshtë një zjarr  
fare i vogël...  
ku digjet meraku i nënës time.*

## *PËRMBAJTA*

Fillim . . . . .	3
Vrull . . . . .	6
Paradite . . . . .	7
Shkak . . . . .	8
Rrallim . . . . .	9
Komça . . . . .	10
Notkun . . . . .	11
Do ta them . . . . .	12
Dallëndyshet . . . . .	13
Oreks . . . . .	14
Optimizëm . . . . .	15
Kuptim . . . . .	16
Borxhi . . . . .	17
Sqarim . . . . .	18
Një copë gazete . . . . .	19
Moment i volitshëm . . . . .	21
E dielë reale . . . . .	22
Në dritare . . . . .	24
Pikëllim . . . . .	25
Po qe se . . . . .	26
Natë . . . . .	27
Pamje e pjesshme . . . . .	28
Shpresë . . . . .	29
Dil në telefon nesër . . . . .	30
Asgjesim . . . . .	31
Deti . . . . .	32
E bukur . . . . .	33

Çast . . . . .	34
Fyelli . . . . .	35
Puthje . . . . .	36
Sekondë . . . . .	37
Çështje . . . . .	38
Kujtim. . . . .	39
Nga era . . . . .	40
Dita e verës . . . . .	41
Rrudhë . . . . .	42
Dekor . . . . .	43
Rruzulli. . . . .	44
Alkool . . . . .	45
Lëvorja. . . . .	46
Zemërgjerësi. . . . .	47
Ende të njomë. . . . .	48
Send . . . . .	49
Ekuilibër . . . . .	50
Çlirim. . . . .	51
Mimoza P . . . . .	52
Ishe . . . . .	53
Qenie . . . . .	54
Zogun. . . . .	55
Dimër . . . . .	56
Trupat. . . . .	57
Ujëvarë . . . . .	58
E diel . . . . .	59
E ëma. . . . .	60
Udhë. . . . .	61
Mimoza. . . . .	62